

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR SHËRBIMET E PAGESAVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektligjit, i hartuar me asistencën e Bankës Botërore dhe Bankën e Italisë, është krijimi i kuadrit ligjor për funksionimin e shërbimeve të pagesave në Republikën e Shqipërisë. Për këtë qëllim projektligji krijon kushte dhe rregulla për:

- a) krijimin, licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave;
- b) transparencën e kushteve dhe kërkesat për informim për shërbimet e pagesave;
- c) të drejtat e detyrimet përkatëse të përdoruesve dhe të ofruesve të shërbimeve të pagesave lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave.

Objektivi i këtij projektligji është promovimi i përfshirjes financiare të popullsisë dhe nxitja e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave. Më konkretisht, ky projektligj vlerësohet se do të mbështesë ndjeshëm në përmbushjen e objektivave të strategjisë kombëtare të pagesave, për pagesat me vlerë të vogël, si më poshtë vijon:

- a) Nxitja e përdorimit intensiv të instrumenteve moderne të pagesave (plotësisht elektronike) me vlerë të vogël në të gjithë vendin, me qëllim arritjen e 10 pagesave jo me para fizike për frymë, deri në fund të vitit 2022;
- b) Zgjerimi i mundësisë për aksesin në llogaritë e transaksioneve është një kusht i domosdoshëm për të arritur objektivin kryesor, duke synuar arritjen e një raporti të zotërimit të llogarisë në nivelin 70% deri në vitin 2022.

Në këtë kontekst, projektligji synon të sigurojë paanshmëri dhe proporcionalitet në licencimin dhe rregullimin e ofruesve të shërbimit të pagesave, të mundësojë modele inovative të biznesit, të cilat lehtësojnë përdorimin për palët e treta (p.sh., shërbime agjenti) dhe burime nga jashtë, të forcojë bazën ligjore mbikëqyrëse të BSH-së për shërbimet e pagesave, të krijojë një kuadër për mbrojtjen e konsumatorit, përfshirë mekanizmat monitorues dhe detyrues, si

dhe të zgjidhë mosmarrëveshjet në mënyrë efektive. Më konkretisht, vlerësohet se:

- a) Miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji vlerësohet se do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në nxitjen e konkurrencës dhe inovacionit në fushën e pagesave me vlerë të vogël duke promovuar kështu efikasitetin e tyre dhe reduktimin e kostove, të cilat mbart përdorimi i tyre. Shërbimet inovative të promovuara nga ky projektligj konsistojnë në shërbimet e iniciimit të pagesave dhe institucionet për shërbimin e informimit për llogarinë. Me qëllim realizimin e shërbimeve të sipërcituara në projektligj, përcaktohet koncepti i shërbimit të llogarisë tipikisht është një bankë që zotëron llogaritë e klientëve dhe duhet që banka të jap informacion, pas autorizimit të klientit për ofruesit e shërbimeve të sipërcituara. Ky shërbim krijon konceptin e *open banking*, duke detyruar bankat të ndajnë informacion për llogarinë e klientit me palë të treta, gjithashtu institucione të licencuara nga BSH (institucionet e shërbimit të iniciimit të pagesës dhe institucionet për shërbimin e informimit për llogarinë).

HAPËSIRË INFORMUESE

Institucionet për shërbimin e iniciimin e pagesave

Ofruesit e shërbimeve të iniciimit të pagesave zakonisht i ndihmojnë konsumatorët të bëjnë pagesa në internet e të informojnë menjëherë tregtarin për iniciimin e pagesës, duke lehtësuar kështu tregtinë elektronike. Këto institucione mundësojnë shfrytëzimin e tregtisë elektronike edhe nga konsumatorë, të cilët nuk zotërojnë një kartë debiti apo krediti, por kanë një llogari bankare të aksesueshme nga interneti.

Institucionet për shërbimin e informimit mbi llogarinë

Shërbimet e informimit të llogarisë u mundësojnë konsumatorëve dhe bizneseve të kenë një pamje globale/të plotë për gjendjen e tyre financiare, për shembull, duke u mundësuar konsumatorëve të konsolidojnë llogaritë e ndryshme rrjedhëse që mund të kenë me një ose më shumë banka e të kategorizojnë shpenzimet e tyre sipas tipologjive të ndryshme (ushqim, energji, qira, kohë të lirë etj.), duke i ndihmuar kështu në buxhetimin dhe planifikimin financiar.

Institucionet për shërbimin e llogarisë

Lëshimi/emetimi i një instrumenti të pagesës është një nga shërbimet e pagesave që është brenda fushës së veprimit të direktivës. Secili ofrues i shërbimeve të pagesave, një bankë ose një institucion pagese, mund të emetojë

instrumente pagesash. Instrumentet e pagesës nuk mbulojnë vetëm kartat e pagesave, siç janë kartat e debitit dhe kartat e kreditit, por çdo pajisje e personalizuar ose rregull i rënë dakord ndërmjet emetuesit dhe përdoruesit që përdoret për të iniciuar një pagesë.

Në këto kushte, institucionet e shërbimeve të llogarisë mundësojnë që ofruesit e shërbimeve të pagesave, të cilët nuk administrojnë llogarinë e përdoruesit të shërbimeve të pagesave, të kenë mundësi të emetojnë instrumente të pagesave të bazuara në karta dhe ekzekutimin e pagesave të kryera me to. Më në detaje, ofruesi i shërbimeve të pagesave nëpërmjet këtyre shërbimeve, mund të informohet, me pëlqimin e përdoruesit, mbi gjendjen e llogarisë në një institucion tjetër dhe kështu të mundësohet ekzekutimi i pagesës duke eliminuar dhe rrezikun e kredisë ndërmjet palëve.

- b) Projektligji në fjalë synon të balancojë hapësirat për ofrimin e shërbimeve të pagesave ndërmjet bankave dhe institucioneve financiare jo banka, duke lejuar këto të fundit të hapin llogari pagese dhe emetojnë instrumente elektronike të pagesave.
- c) Në kuadër të ndërveprimit ndërmjet bankave dhe jo bankave projektligji parashikon dhe disa dispozita, të cilat synojnë të eliminojnë praktikën bllokuese ndaj institucioneve financiare jo banka për arsye konkurrence. Më konkretisht, projektligji:
 - d)
 - i. Sanksionon të drejtën e institucioneve të pagesave për të hapur llogari pranë një banke dhe për ofrimin e shërbimeve përkatëse. Në rast refuzimi banka duhet të raportojë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë për arsyet e refuzimit. Kjo dispozitë synon të eliminojë praktikën abuzive të ndjekura nga bankat në kuadër të *derisking*.
 - ii. Sanksionon të drejtën e institucioneve të pagesave për të marrë pjesë në sistemet e pagesave (direkt kur këto sisteme nuk janë me rëndësi sistemike dhe indirekt nëpërmjet një banke kur ato janë me rëndësi sistemike si në rastin e AIPS-së).
- e) Për më shumë, projektligji vlerësohet të ***rrisë transparencën në shërbimet e ofruara nga tregu e të krijojë një kuadër të konsoliduar për mbrojtjen e konsumatorit***. Vlen të theksohet se projektligji parashikon krijimin e njësive brenda institucioneve për adresimin e mbrojtjes së përdoruesve të shërbimeve të pagesave (të ngjashme me atë të kredisë konsumatore), si dhe një njësi të posaçme për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve brenda Bankës së Shqipërisë. Ky zhvillim është në linjë dhe me rishikimet e fundit të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorit” nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- f) Projektligji synon të zgjerojë prezencën e shërbimeve të ofruara nga bankat në të gjithë territorin (përfshirë dhe zonat rurale) nëpërmjet

prezantimit dhe rregullimit të modelit “të bankave të cilat ofrojnë shërbime pagesash nëpërmjet agjentëve” (aktualisht bankat operojnë vetëm me degë).

- g) Projektligji, si dhe nisma të tjera rregullative të parashikuara në planin e veprimit të strategjisë “Për pagesat me vlerë të vogël” të synuara nga Banka e Shqipërisë, vlerësohet se kontribuojnë në krijimin e institucioneve financiare me një qeverisje të mirërregulluar dhe struktura për administrimin e rrezikut, duke ndihmuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në nxitjen e sigurisë dhe efikasitetit në tregun e shërbimeve të pagesave. Zbatimi i këtyre praktikave evropiane ndikon dhe në rritjen e besimit ndaj institucioneve shqiptare të pagesave në rrafshin ndërkufitar.
- h) Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, ky projektligj rregullon më tej institucionet e parasë elektronike, për sa u përket kushteve të transparencës dhe të drejtave dhe detyrimeve të palëve. Më në detaje në nivel evropian, direktiva “Për paranë elektronike” rregullon pjesën e krijimit dhe funksionimit të institucionit ndërkohë shërbimet e ofruara nga këto institucione rregullohen nga PSD1 dhe në vijim PSD2. Në këtë drejtim vlerësohet se projektligji përafron më tej rregullimin e institucioneve të parasë elektronike me praktikat evropiane, një detyrim ky i ngritur disa herë nga Komisioni Evropian në kuadër të kapitullit 4 “Për lëvizjen e lirë të kapitalit”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Projektligji për shërbimet e pagesave nuk është parashikuar në programin analitik të akteve të miratuara me vendimin nr.764, datë 27.12.2018, “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019”. Megjithatë, vlen të theksohet se ky projektligj është një kërkesë e vazhdueshme e Komisionit Evropian për kapitullin 4, “Lëvizja e lirë e kapitalit”, si baza kryesore e *aquis* për tregun e vetëm të pagesave në “euro”, të ashtuquajturin SEPA. Për më shumë, ky projektligj përbën një prioritet edhe për Strategjinë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël, e cila synon modernizimin e këtij tregu, me qëllim zgjerimin e përfshirjes financiare të popullsisë shqiptare, e cila rezulton në nivele relativisht të ulëta krahasuar me vendet e tjera të rajonit, por dhe më gjerë. Së fundi, projektligji është përfshirë dhe në planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nevojat dhe detyrimet e për hartimin e projektligjit.

- Një detyrim në kuadër të integritetit dhe më konkretisht përmbushjen e detyrimeve të Bankës së Shqipërisë lidhur me kapitullin 4, “Lëvizja e lirë e kapitalit”. Vlen të theksohet se kërkesa për zbatimin e Direktivës nga ana e Komisionit Evropian është tejet e hershme (që prej vitit 2010);
- Parakusht i nevojshëm për integrimin me tregun e përbashkët të pagesave në Euro (*Single Euro Payment Area*);
- Një hap thelbësor në kuadër të zbatimit të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Tregun e Pagesave me Vlerë të Vogël, duke përmbushur një sërë fushash, të planit të veprimit të kësaj strategjie me qëllim reduktimin e përdorimit të parasë fizike (*cash-it*) në ekonomi dhe nxitjes së përfshirjes financiare;
- Përmbushje e strategjisë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë dhe atë të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave;
- Mbështet realizimin e objektivave të përbashkëta të Ministrit të Shtetit për Diasporën, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për remitancat dhe diasporën;
- Krijimin e parakushteve të nevojshme për krijimin e njesisë ZAM (Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve) për sa i përket pjesës së shërbimeve të pagesave sipas kërkesave të rishikimeve të fundit të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit.

Situata aktuale, problematikat dhe vakumet ligjore

Ligjet dhe rregulloret e Bankës së Shqipërisë janë ndryshuar për t’iu përshtatur teknologjive dhe modeleve të reja të biznesit. Për shembull, ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” ofron mundësinë që IFJB-të të konkurrojnë në tregun e pagesave, përfshirë emetimin dhe operimin e parasë elektronike (pasi të jenë licencuar si institucione të parasë elektronike). Më tej, janë krijuar themelet ligjore për sigurimin e shërbimeve financiare digjitale për pagesat elektronike, nënshkrimet elektronike, komunikimet elektronike dhe identifikimin elektronik të klientëve.

Në bazë të ligjeve ekzistuese, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar një tërësi rregulloresh që mbulojnë në detaje një gamë të gjerë aspektesh që lidhen me sistemet, instrumentet dhe shërbimet e pagesave. Ndër të tjera, këtu përfshihen:

- a) rregulloret që përcaktojnë kriteret, procedurat dhe kushtet për licencimin e IFJB-ve për të ofruar shërbimet e pagesave dhe për subjektet e licencuara për të operuar në sistemin e pagesave apo shtëpitë e klerimit;
- b) rregulloret për licencimin, operimin dhe administrimin e skemave të pagesave kombëtare me kartë; rregulloret për pagesat në formë elektronike;

- c) rregulloret për administrimin e rrezikut në veprimtaritë e pagesave të bankave dhe të IFJB-ve, përfshirë pagesat me jashtë; dhe
- d) rregulloret e PPP/FT-së.

Janë zhvilluar aspekte thelbësore për të mbështetur shtimin e veprimeve të klientit në llogaritë e transaksioneve dhe me instrumente bashkëkohore të pagesave, bazuar në ligje dhe në rregullore të ndryshme. Shumë çështje në këtë fushë, të tilla si:

- a) mbrojtja e fondeve të klientëve të mbajtura në llogaritë e transaksioneve;
- b) transparenca për shërbimet e pagesave; ose
- c) mekanizmat për pretendimet e konsumatorit përcaktohen në disa prej rregulloreve të BSH-së.

Për më shumë, ekziston sigurimi i depozitave, i cili mbulon paratë e depozituara në banka dhe në SHKK, ndërsa fondet në llogaritë e parasë elektronike mbrohen nëpërmjet dispozitave të tjera.

Megjithatë, kuadri ligjor dhe rregullativ aktual kërkon një zhvillim të mëtejshëm në një sërë aspektesh për të qenë në linjë me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe për të adresuar zhvillimet e tregut. Më konkretisht, nevojitet ndërhyrje lidhur me:

- a) ridimensionimin e rolit të institucioneve financiare jo banka në tregun e pagesave me qëllim krijimin e rregullave jodiskriminuese për hyrje dhe kushtet për pjesëmarrje në treg, për të ofruar shërbime të pagesave me vlerë të vogël;
- b) rregullimin e shërbimeve inovative të prezantuara në tregjet ndërkombëtare;
- c) arritjen e një metodologjie më të qëndrueshme në licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe të institucioneve financiare jo banka që ofrojnë shërbimet e pagesave;
- ç) sigurimin e një rregulloreje koherente lidhur me nënkontraktimin e shërbimeve (*outsourcing*), duke përfshirë zhvillimin e një kuadri gjithëpërfshirës për përdorimin e agjentëve dhe nënagjentëve në sigurimin e shërbimeve të pagesave;
- d) zhvillimin e një kuadri më të fortë për mbrojtjen e përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe kushtet e transparencës.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar mbështetet në nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektligji ka si qëllim krijimin e bazës ligjore për shërbimet e pagesave në Republikën e Shqipërisë dhe synon të përafrojë pjesërisht legjislacionin shqiptar me Direktivën 2015/2366 BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 25 nëntor 2015, “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm”, që ndryshon Direktivat 2002/65/EC, 2009/110/EC dhe 2013/36/EU dhe rregulloren (EU) nr.1093/2010, dhe shfuqizon Direktivën 2007/64/EC.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Titulli I: Dispozita të përgjithshme

Titulli I i projektligjit parashikon në nene të veçanta objektin, qëllimin, fushën e zbatimit/subjektet, përjashtimet dhe përkufizimet.

Objekti i projektligjit (neni 1) është përcaktimi i kushteve dhe rregullave për:

- a) krijimin, licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave;
- b) transparencën e kushteve dhe kërkesat për informim për shërbimet e pagesave;
- c) të drejtat dhe detyrimet përkatëse të përdoruesve dhe të ofruesve të shërbimeve të pagesave në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave.

Bazuar në këtë projektligj, do të trajtohen institucionet e pagesave, të cilat do të ofrojnë dhe kryejnë shërbime pagesash sipas listimit konkret që bëhet në aneksin 1, bashkëlidhur projektligjit dhe që kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Krijimi i këtyre institucioneve përbën një risi në tregun financiar shqiptar. Aktualisht, veprimtaria e shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave ofrohet nga bankat, në zbatim të dispozitave të ligjit për bankat dhe nga subjektet financiare jo banka e institucionet e parasë elektronike, të cilat janë licencuar për të kryer veprimtarinë e shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave. Në bazë të kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, veprimtarinë e shërbimit të pagesave dhe të transferimit të parave mund ta ushtrojnë edhe shoqëritë e kursim-kreditit. Bankat ushtrojnë edhe veprimtarinë e emetimit dhe të administrimit të instrumenteve të pagesës (të tilla, si: kartat e kreditit dhe të debitit, çeket e udhëtarit dhe çeket bankare, kartat e pagesës dhe pagesat me celular etj.),

përfshirë emetimin e parasë elektronike (shkronja “f”, e pikës 2, të nenit 54, të ligjit për bankat).

Projektligji “Për shërbimet e pagesave”, duke rregulluar në mënyrë të detajuar shërbimet e pagesave dhe duke përcaktuar llojin e shërbimit që kryejnë subjektet, i njeh të drejtën bankave dhe institucioneve të parasë elektronike të kryejnë këto shërbime dhe krijon mundësi që edhe subjekte të tjera të afrohen në kryerjen e shërbimeve të pagesave, pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë projektligj.

Subjekte të zbatimit të këtij projektligji (neni 3) janë bankat, institucionet e parasë elektronike, institucionet e pagesave, si edhe Banka e Shqipërisë, autoritetet publike dhe autoritetet qendrore ose vendore, kur nuk veprojnë përkatësisht në cilësinë e autoritetit monetar dhe në cilësinë e autoritetit publik e ofrojnë shërbime pagesash. Kjo dispozitë e projektligjit, ashtu si direktiva synon të krijojë hapësira për këto institucione publike të ofrojnë shërbime pagesash për arsye kryesisht administrative. Për ta qartësuar fushën e veprimit të këtyre shërbimeve të pagesave të ofruara nga autoritetet, po sjellim disa shembuj të cilët mund të konsiderohen si më përfaqësues: ofrimi i mundësisë së kryerjes së pagesave të faturave utilitare (si p.sh. telefoni) nga institucioni për llogari të punonjësve; emetimi i kartave për marrjen e subvencioneve të ndryshme ose pagesave të tjera (shembull konkret në këtë drejtim mund të përbëjnë praktikën e disa bankave qendrore të Bashkimit Evropian, të cilat, për subvencionimin e ushqimit gjatë orarit të punës, emetojnë karta të parapaguara, të cilat punonjësit mund t’i përdorin në restorante të ndryshme). Pra, në thelb, shërbimet e ofruara nga autoritetet synojnë eliminimin e përdorimit të *cash*-it në pagesat e tyre për qëllime administrative.

Në projektligj është parashikuar që shoqëritë e kursim-kreditit dhe subjektet financiare jo banka, të cilat kërkojnë të ushtrojnë edhe veprimtaritë e pagesave, të trajtohen si institucione të pagesave dhe të pajisen me licencë të veçantë.

Në anën tjetër, në projektligj janë përcaktuar një numër i konsiderueshëm rastesh të ndryshme për të cilat nuk zbatohen dispozitat e projektligjit, duke i përjashtuar (neni 4) ato nga fusha e zbatimit të tij, si për shembull:

- pagesat *cash*;
- pagesat me çek, kambial, letra premtimi etj.;
- transaksionet e këmbimit valutor me para fizike (*cash*), kur fondet nuk mbahen në një llogari pagese;
- pagesat ndërmjet ofruesve të shërbimeve ndërmjet njëri-tjetrit;
- pagesat ndërmjet një shoqërie mëmë dhe degës së saj ose ndërmjet filialeve të të njëjtës shoqërie mëmë, pa asnjë ndërhyrje ndërmjetësimi

nga një ofrues i shërbimeve të pagesave, përveç rastit kur është një shoqëri që i përket të njëjtit grup etj.

Së fundi, në titullin I, të projektligjit, janë renditur përkufizimet (neni 5) e përshtatura sipas legjislacionit shqiptar në fuqi në rastet kur ka qenë e mundur.

Titulli II: Ofruesit e shërbimeve të pagesave

Në titullin II të projektligjit trajtohen kryesisht çështjet që kanë të bëjnë me licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave. Në këtë titull janë parashikuar kriteret dhe kërkesat për dokumentacionin që duhet të plotësojnë subjektet aplikuese, për marrjen e licencës si institucion i pagesës për ushtrimin e veprimtarive të shërbimeve të pagesave sipas aneksit 1, të projektligjit.

Në nenin 6 të projektligjit, Bankës së Shqipërisë i jepet autoriteti për licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave, si dhe revokimin e licencës së dhënë kur shkelen apo nuk plotësohen më kushtet mbi të cilat është dhënë licenca. Gjithashtu, po në këtë nen sanksionohet ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë së shërbimeve të pagesave nga çdo subjekt që nuk është i pajisur me licencë apo nuk është i regjistruar në regjistrin e institucioneve të pagesave nga Banka e Shqipërisë.

Për të marrë licencën si institucion i pagesave, përfaqësuesit e shoqërisë paraqesin në Bankën e Shqipërisë një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me dokumentacionin dhe informacionin sipas kërkesave të renditura në nenin 7, të projektligjit. Pjesë e dokumentacionit që shoqëron aplikimin për licencë është statuti i shoqërisë, lista me të dhënat për identitetin dhe reputacionin e aksionarëve/ortakëve me pjesëmarrje influencuese të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, evidenca për zotërimin e kapitalit fillestar minimal, identiteti i administratorit dhe/ose i personit/ave përgjegjës për administrimin e institucionit të pagesave dhe evidenca që ata kanë reputacion të mirë, zotërojnë njohuri dhe kanë eksperiencë për kryerjen e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave, përshkrimi i veprimtarisë që parashikohet të kryhet, lloji i shërbimeve të pagesave sipas aneksit 1, planbiznesi për 3 vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë, ku të evidentohet që aplikuesi do të përdorë sisteme, burime dhe procedura të përshtatshme e proporcionale për të siguruar një gjendje financiare të qëndrueshme. Për vetë specifikën që ka veprimtaria e shërbimeve të pagesave, pjesë e kërkesës për licencim janë edhe një sërë dokumentash e procedurash që lidhen kryesisht me masat për sigurimin e fondeve të përdoruesve të shërbimeve të pagesave, me monitorimin, trajtimin dhe ndjekjen e incidenteve të sigurisë dhe ankimeve të klientëve, përshkrimin e masave qeverisëse dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm, përfshirë procedurat administrative të shoqërisë, të administrimit të rrezikut dhe të kontabilitetit,

politikën e sigurisë në të cilën përfshihet një vlerësim i detajuar i rrezikut që lidhet me shërbimet e pagesave, për kontrollin e sigurisë dhe masat zbutëse për të mbrojtur mjaftueshëm përdoruesit e shërbimeve të pagesave ndaj rreziqeve të identifikuar (përfshirë mashtrimin dhe përdorimin e paligjshëm të të dhënave personale dhe sensitive), përshkrimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm për zbatimin e kërkesave të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përshkrimin e masave për vazhdimësinë e biznesit (duke përfshirë identifikimin e qartë të operacioneve kritike, planet efektive të emergjencës etj.), përshkrimin e procesit të dokumentimit, monitorimit, ndjekjes dhe kufizimit të aksesit në të dhënat sensitive të pagesave, përshkrimin e strukturës organizative të aplikuesit, përfshirë edhe përdorimin e agjentëve dhe të degëve, si edhe kontrollet nga jashtë dhe në vend (*off-site*, *on-site*), që aplikuesi do të kryejë pranë tyre të paktën një herë në vit, përshkrimin e marrëveshjeve me të tretët dhe të pjesëmarrjes në sistemet kombëtare ose ndërkombëtare të pagesave etj.

Ndërkohë, Banka e Shqipërisë, nëpërmjet akteve rregullative, do të vendosë kriteret për shumën monetare minimale për sigurimin e dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme për veprimtaritë e shërbimeve të pagesave shërbimi i inicimit të pagesës dhe shërbimi i informimit mbi llogarinë. Aktet nënligjore do të hartohen mbështetur në rregulloret dhe udhëzimet e Komisionit Europian dhe Autoritetit Bankar Europian (EBA).

Në nenin 8 të projektligjit parashikohen dispozitat lidhur me zotërimin e kapitalit të institucionit të pagesës. Çdo person fizik ose juridik që synon të zotërojë pjesëmarrje influencuese ($\geq 10\%$ të kapitalit të institucionit të pagesës) të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose ta rrisë këtë pjesëmarrje, duke tejkaluar 20%, 30% ose 50%, ose që institucioni i pagesës të bëhet filiali i tij, informon paraprakisht me shkrim për këtë qëllim Bankën e Shqipërisë. Me akt rregullativ të Bankës së Shqipërisë do të përcaktohen kërkesat dhe kriteret që duhet të plotësojë personi fizik ose juridik që do të kërkojë të zotërojë pjesëmarrje influencuese në kapitalin e institucionit të pagesës. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të refuzojë zotërimin/ ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese, kur e gjykon që ky zotërim do të ndikojë në përkeqësimin e administrimit të shëndetshëm dhe të kujdesshëm të institucionit të pagesës.

Për sa i takon kërkesave për kapital dhe mjaftueshmërisë së tij, për të ushtruar një veprimtari të qëndrueshme dhe të sigurt, ato parashikohen në nenet 9-11 të projektligjit. Gjatë konsultimeve të grupit të punës dhe në ndryshim nga direktiva, është gjykuar më e arsyeshme që niveli minimal i kapitalit fillestar, përbërësit e tij (neni 9-10), si edhe tri metodat e parashikuara në direktivë për llogaritjen e mjaftueshmërisë së tij të rregullohen nëpërmjet akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë. Kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit për institucionet

e pagesës bazohen kryesisht në volumin e transaksioneve të realizuara nga këto institucione (neni 11).

Projektligji parashikon gjithashtu se Banka e Shqipërisë, si autoritet përgjegjës, ka të drejtën që:

1. të marrë masat e nevojshme për të siguruar që elementet përbërëse të kapitalit, në kuadër të llogaritjes së mjaftueshmërisë së tij, të mos cenohen në rastet kur një institucion i pagesës është njëkohësisht pjesë e të njëjtit grup me një institucion tjetër pagese, bankë, fond investimi, shoqëri sigurimi etj., ose ka karakter hibrid; si edhe
2. të kërkojë që vlera e kapitalit të institucionit të pagesës të jetë deri në 20% më e lartë se ajo e përcaktuar në aktet nënligjore, bazuar në vlerësimin e rrezikut të këtij institucioni.

Projektligji parashikon gjithashtu kërkesat për ruajtjen e fondeve të marra nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave për kryerjen e transaksioneve të pagesave. Neni 12 përcakton qartë se institucioni i pagesës duhet t'i mbajë këto fonde në një llogari të veçantë në një bankë ose t'i investojë ato në aktive të sigurta, të konvertueshme në para/likuide, me rrezik të ulët; këto fonde nuk mund të konfiskohen ose të jenë subjekt i procedurave të falimentimit. Gjithashtu, projektligji parashikon si një formë të mundshme për ruajtjen e fondeve të marra nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave, edhe sigurimin e tyre me një policë sigurimi nga një shoqëri sigurimi, ose me një garanci tjetër të njëjtë me të, nga një bankë, ku shoqëria e sigurimit apo banka nuk i përket të njëjtit grup të institucionit të pagesës.

Procesi i licencimit të institucionit të pagesës nga Banka e Shqipërisë do të realizohet nëpërmjet vlerësimit dhe shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit dhe informacionit që shoqëron kërkesën e subjektit aplikues, të cilat duhet të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullative (neni 13). Në këtë proces, Banka e Shqipërisë bashkëpunon edhe me autoritete të tjera vendase për të bërë verifikime të pavarura për të provuar vërtetësinë e informacionit të paraqitur nga subjekti aplikues. Rëndësi në këtë proces i kushtohet, përveç të tjerave, edhe cilësisë së aksionerëve/ortakëve me pjesëmarrje influencuese dhe të administratorëve, për të siguruar një administrim të kujdesshëm e të shëndoshë të institucionit të pagesave.

Mbështetur në direktivën e shërbimeve të pagesave, edhe në projektligj është parashikuar që, në rastet kur subjekti aplikues për institucion pagese është i përfshirë edhe në veprimtari të tjera tregtare, Banka e Shqipërisë mund të kërkojë krijimin e një shoqërie (subjekti) të veçantë, që të ushtrojë vetëm veprimtarinë e shërbimeve të pagesave. Ky parashikim lidhet me rastet kur gjykohet dhe vlerësohet se ushtrimi i veprimtarive të tjera, që nuk janë shërbime

pagesash, pengojnë apo mund të dëmtojnë qëndrueshmërinë financiare të institucionit të pagesave, ose të pengojnë Bankën e Shqipërisë për të monitoruar pajtueshmërinë e institucionit të pagesës me të gjitha detyrimet e përcaktuara në projektligj dhe në kuadrin rregullativ.

Afatet e komunikimit të vendimit të Bankës së Shqipërisë për dhënien ose refuzimin e licencës së institucionit të pagesës janë parashikuar në nenin 14, të projektligjit. Brenda tre muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë, subjektit aplikues i dërgohet vendimi i Bankës së Shqipërisë, i shoqëruar edhe me arsyet përkatëse në rastet e refuzimit.

Nëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shërbimeve të pagesave, institucioni i pagesave nuk plotëson dhe nuk përmbush të gjitha detyrimet ligjore dhe rregullative, Banka e Shqipërisë ka të drejtën ta revokojë licencën e dhënë. Rastet e revokimit të licencës së institucionit të pagesave janë parashikuar në nenin 15, të projektligjit, dhe konsistojnë ndër të tjera, në: dhënien e informacionit të rremë gjatë licencimit, mosplotësimin e kushteve sipas të cilave është dhënë licenca dhe mosinformimin e Bankës së Shqipërisë në rast të ndryshimit të këtyre kushteve, kërcënimin që paraqet për stabilitetin dhe besimin e sistemeve të pagesave etj. Në vendimin e revokimit të licencës, Banka e Shqipërisë do të japë arsyet dhe do të njoftojë palët e interesuara. Vendimi i revokimit botohet në buletin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Institucionet e pagesave, të cilat janë pajisur me licencë nga Banka e Shqipërisë ose që kanë përfituar nga përjashtimet sipas neneve 27 ose 28, të projektligjit, dhe agjentët e tyre regjistrohen në regjistrin publik, që publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë. Regjistri do të përmbajë të dhënat për shërbimet e pagesave që do të ofrojë çdo institucion i pagesave. Çdo revokim licence ose ndryshim lidhur me përjashtimet sipas neneve 27 ose 28, do të publikohet gjithashtu në regjistër.

Për çdo ndryshim në faktet e rrethanat mbi të cilat është dhënë licenca, institucioni i pagesave ka detyrimin të njoftojë Bankën e Shqipërisë menjëherë dhe jo më vonë se 15 ditë pas ndodhjes së ndryshimit, sipas parashikimeve në nenin 17 të projektligjit.

Neni 18 përcakton kërkesat për llogaritë kontabël dhe përgatitjen e raporteve financiare, në përputhje me rregullat dhe parimet kontabël dhe sipas legjislacionit në fuqi “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, mbi baza individuale ose të konsoliduara. Njëkohësisht, ky nen vendos kërkesa për auditimin e llogarive vjetore dhe të llogarive të konsoliduara të institucioneve të pagesave, sipas legjislacionit në fuqi. Ndërkohë, ky nen parashikon përcaktimin me akt nënligjor të formës, tipit, metodologjisë, përmbajtjes së raporteve dhe kohës së raportimit të institucioneve të pagesës në Bankën e Shqipërisë. Në

tërësinë e tij, ky nen i projektligjit është përshtatur me kërkesat e ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim harmonizimin e kërkesave për kontabilitetin dhe auditimin ligjor, për të gjitha subjektet raportuese në Bankën e Shqipërisë.

Neni 19 parashikon të drejtën e institucioneve të pagesës për të kryer edhe veprimtari të tjera, të ndryshme nga ato të ofrimit të shërbimeve të pagesave, të cilat kryesisht janë në funksion të kryerjes së shërbimeve të pagesave (për shembull: shërbime operacionale dhe ndihmëse që mundësojnë ekzekutimin e transaksioneve të pagesave, shërbimet e këmbimit valutor, ruajtjen dhe përpunimi i të dhënave, funksionimin e sistemeve të pagesave, si dhe veprimtari të tjera, të ndryshme nga ato të ofrimit të shërbimit të pagesave). Ky nen përcakton gjithashtu se fondet e marra nga institucionet e pagesave prej përdoruesve të shërbimeve të pagesave nuk konsiderohen depozita apo fonde të tjera të ripagueshme dhe as para elektronike, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për bankat. Në asnjë rast, institucionet e pagesave nuk lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e pranimit të depozitave ose të fondeve të tjera të ripagueshme. Një element i rëndësishëm që paraqitet në këtë nen lidhet me të drejtën e institucioneve të pagesave për të dhënë kredi në funksion të kryerjes së shërbimit të pagesës, përkundrejt plotësimit të njëkohshëm të disa kushteve, si dhe të plotësimit të kërkesave ligjore për mbrojtjen e konsumatorëve. Në të njëjtat kushte, këto të drejta i gëzojnë edhe institucionet e parasë elektronike.

Neni 20 i projektligjit “Operimi i sistemeve të pagesave” u mundëson ofruesve të shërbimeve të pagesave të drejtën për të operuar sisteme pagesash. Më konkretisht, ky nen ka si synim njohjen e të drejtës së operimit të sistemeve të pagesave përtej institucioneve të pagesave (sipas direktivës së shërbimeve të pagesave), edhe institucioneve të parasë elektronike (duke përafruar kështu shkronjën “d”, të pikës 1, të nenit 6, të direktivës së Bashkimit Evropian për paranë elektronike), si dhe bankave. Gjithashtu, ky nen kërkon të sqarojë edhe legjislacionin, të cilin do të zbatojë operatori i sistemit të pagesave në varësi të aktivitetit dhe formës që ka sistemi.

Neni 21, i projektligjit, përafrohet me nenin 19, të direktivës. Sipas këtij neni, institucionet e pagesave mund të përdorin agjentët për ofrimin e shërbimeve të pagesave. Të gjithë agjentët do të regjistrohen në regjistrin publik që do të administrohet nga Banka e Shqipërisë. Përpara se agjentët të përfshihen në regjistër, institucionet e pagesës do të paraqesin në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin dhe informacionin e përcaktuar në këtë nen, për agjentët. Brenda dy muajve pas paraqitjes së dokumentacionit dhe informacionit sipas këtij neni, Banka e Shqipërisë do të njoftojë institucionin e pagesave për përfshirjen e agjentit në regjistër dhe, vetëm pas listimit në regjistër, ky i fundit ka të drejtë të fillojë veprimtarinë në emër dhe për llogari të institucionit të pagesave. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të bëjë verifikime të mëtijshme për

vërtetësinë e informacionit të paraqitur nga subjekti aplikues. Nëse pas verifikimeve rezulton se informacioni i paraqitur nuk është korrekt, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të refuzojë regjistrimin e agentit në regjistrin publik dhe njofton menjëherë institucionin e pagesave. Neni 21, parashikon gjithashtu edhe detyrimin për njoftim në Bankën e Shqipërisë, nga institucioni i pagesës, në rastet kur ky i fundit transferon te të tretët funksionet operacionale të shërbimeve të pagesës. Në rastet kur institucioni i pagesës transferon/delegon te të tretët funksione të rëndësishme operacionale, ai duhet të plotësojë disa kushte të cilat detajohen në projektligj. Transferimi i këtyre funksioneve në asnjë rast nuk mund të ndërmerret, nëse do të dëmtonte materialisht cilësinë e kontrollit të brendshëm të institucionit të pagesës, si dhe aftësinë e Bankës së Shqipërisë për të monitoruar e ndjekur përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore e nënligjore. Institucionet e pagesave duhet të sigurohen se agentët që veprojnë në emër të tyre, i informojnë përdoruesit e shërbimit të pagesave për këtë fakt dhe njëkohësisht kanë detyrimin për njoftim të Bankës së Shqipërisë për çdo ndryshim në subjektet të cilave u kanë transferuar funksionet operacionale apo në agentët që përdorin për ofrimin e shërbimeve të pagesave.

Në nenin 22 të projektligjit parashikohet përgjegjësia e institucioneve të pagesës për të siguruar se palët e treta të caktuara për të kryer funksionet operacionale, marrin masat e nevojshme për të siguruar përmbushjen e kërkesave të këtij ligji, si dhe për çdo veprim të punonjësve të tyre ose të çdo agjenti apo subjekti, të cilit i janë deleguar funksionet e tyre.

Neni 23 parashikon detyrimin e institucioneve të pagesës për të ruajtur të dhënat e nevojshme për të paktën 5 vjet, në funksion të zbatimit me efektivitet të kërkesave të titullit II.

Seksioni 3 “Procesi i mbikëqyrjes” parashikon procesin dhe ushtrimin e funksionit mbikëqyrës nga Banka e Shqipërisë, si autoriteti përgjegjës, i cili monitoron përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit të pagesës me kuadrin ligjor e nënligjor.

Kështu, neni 25 i projektligjit përcakton mënyrat nëpërmjet të cilave Banka e Shqipërisë përmbush këtë funksion, si:

1. kërkesa për informacionin që vlerësohet i nevojshëm, për të monitoruar përputhshmërinë;
2. realizimi i ekzaminimeve në vend pranë institucionit të pagesës, i agentëve apo i degëve që ofrojnë shërbime pagese nën përgjegjësinë e institucionit të pagesës, apo në çdo subjekt tek i cili janë deleguar/kontraktuar funksione operacionale;
3. dhënia e rekomandimeve, udhëzimeve, paralajmërimeve në rastet e shkeljeve ligjore dhe nënligjore, lëshimi i urdhrave për ndërprerjen e

veprimeve të paligjshme dhe korrigjimin e pasojave, vendosja e sanksioneve administrative etj.;

4. pezullimi ose revokimi i licencës. Ushtrimi i funksionit mbikëqyrës shtrihet deri te subjekte të tjera, në rastet kur ato zotërojnë aksione në institucionin e pagesës.

Në nenin 26, të projektligjit, përcaktohet detyrimi i ruajtjes së sekretit profesional për personat që punojnë apo kanë punuar për Bankën e Shqipërisë dhe ekspertët që veprojnë për llogari të saj, si dhe në rastin e shkëmbimit të informacionit në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Në seksionin 4, të titullit II, të kreut I, të projektligjit, është bërë përafrimi me direktivën e shërbimeve të pagesave. Konkretisht, sipas nenit 27, personat fizikë ose juridikë që do të ofrojnë shërbime të pagesave sipas pikave 1-6, të aneksit 1, të projektligjit, përjashtohen nga zbatimi i plotë ose pjesor i procedurave dhe i kushteve të parashikuara në seksionet 1, 2 dhe 3, të këtij kreu, përveç neneve 16, 24, 26 dhe 29, kur mesatarja mujore e shumës totale të transaksioneve të pagesave të kryera gjatë 12 muajve paraardhës, nga personi në fjalë, duke përfshirë edhe agjentët për të cilët ai merr përgjegjësi të plotë, nuk tejkalon limitin e vendosur nga Banka e Shqipërisë dhe asnjë prej personave fizikë përgjegjës për administrimin apo funksionimin e veprimtarisë të mos jetë dënuar për vepra penale që lidhen me pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit ose krime të tjera financiare. Këta persona do të regjistrohen në regjistrin publik dhe do të trajtohen si institucione pagesash dhe duhet të njoftojnë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim të situatës së tyre që lidhet me kushtet e specifikuar në këtë nen. Banka e Shqipërisë merr masat e nevojshme për të siguruar që, në rast se nuk përmbushen më kushtet e përcaktuara në këtë nen, personat në fjalë të kërkojnë licencim brenda 30 ditëve, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 13, të projektligjit.

Për personat fizikë ose juridikë që ofrojnë vetëm shërbimin e informimit të llogarisë, sipas pikës 8, të aneksit 1, të projektligjit, do të zbatohen disa nga procedurat dhe kushtet e parashikuara në seksionet 1 dhe 2, të detajuara në nenin 28, të projektligjit. Këta persona do të trajtohen si institucione të pagesave.

Në nenin 29, të projektligjit, trajtohet pjesëmarrja e ofruesve të shërbimeve të pagesave në sistemet e pagesave, ashtu siç përcaktohet edhe në direktivë, duke parashikuar krijimin e kushteve jodiskriminuese e proporcionale për hyrjen në sistemet e pagesave të personave juridikë të licencuar ose të regjistruar. Kjo dispozitë synon të krijojë kushte të barabarta pjesëmarrjeje ndërmjet aktorëve të ndryshëm në treg. Megjithatë, lidhur me sistemet që respektojnë parimin e finalizimit të shlyerjes, projektligji, ashtu si dhe vetë direktiva, parashikon që këto kushte të mos ekspozojnë sistemin ndaj pjesëmarrësve, të cilët mund të

mbartin rrezik të shtuar (rreziku i shlyerjes, operacional, rreziku i biznesit) dhe të sigurojnë mbrojtjen e stabilitetit financiar e operacional të sistemit të pagesave. Megjithatë, projektligji krijon hapësira për një pjesëmarrje të tërthortë nëpërmjet një pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë (ku, si rregull, janë bankat). Gjithashtu, këta pjesëmarrës të tërthortë nuk gëzojnë të njëjtat të drejta nga mbrojtja e dhënë nga direktiva e finalitetit të shlyerjes (ligji në fuqi për sistemin e pagesave). Për më shumë, projektligji i zhvesh nga këto detyrime sistemet e krijuara dhe të operuara nga një ofrues shërbimesh pagesash për qëllime të vetë institucionit.

Në nenin 30, të projektligjit, trajtohet mundësia e institucioneve të pagesave dhe të parasë elektronike, për të pasur akses në shërbimet e ofruara nga bankat, si p.sh. për hapjen dhe përdorimin e një llogarie të institucionit, e cila mundëson veprimtarinë e pagesës, si dhe shërbime të tjera në lidhje me këto shërbime. Vlen të theksohet se projektligji parashikon se në rastet kur kjo pjesëmarrje do të refuzohet (si për pjesëmarrjen në sisteme, ashtu edhe në rastin e aksesit në llogaritë e mbajtura me bankat), bankat do t'u paraqesin ofruesve të shërbimeve të pagesave ose Bankës së Shqipërisë (sipas rastit) arsyetimin e detajuar në lidhje me këtë refuzim.

Në nenin 31, të projektligjit, është parashikuar që të gjithë personat fizikë ose juridikë që nuk janë ofrues të shërbimeve të pagesave ose nuk janë të përjashtuar shprehimisht nga fusha e zbatimit të projektligjit, nuk mund të ofrojnë shërbimet e pagesave. Për rastet e ushtrimit të shërbimeve të bazuara në një instrument specifik pagese¹, të referuara në nënndarjet (i) dhe (ii), të shkronjës “gj”, të nenit 4, të projektligjit, për të cilat vlera totale e transaksioneve të pagesave të kryera brenda 12 muajve paraardhës, tejkalon shumën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, ofruesit e këtyre shërbimeve duhet të dërgojnë një njoftim në Bankën e Shqipërisë, që përshkruan shërbimet e ofruara, duke specifikuar në cilin përjashtim të referuar në nënndarjet (i) dhe (ii), të shkronjës “gj”, të nenit 4, konsiderohet të kryhet aktiviteti. Mbi bazën e këtij njoftimi, Banka e Shqipërisë merr një vendim të mirargumentuar sipas kriterit të referuar në shkronjën “gj”, të nenit 4, kur aktiviteti i ofruesit të shërbimit nuk kualifikohet më si një rrjet i kufizuar dhe informon ofruesin e shërbimit sipas rastit. Gjithashtu, ofruesit e shërbimeve që kryejnë një veprimtari sipas shkronjës “h”², të nenit 4, kanë detyrimin të dërgojnë një

¹ Instrumenti lejon mbajtësin të blejë mallra dhe shërbime vetëm në vendndodhjet e emetuesit ose brenda një rrjeti të kufizuar të ofruesve të shërbimeve në bazë të marrëveshjes së drejtpërdrejtë tregtare me një emetues profesional dhe/ose instrumentet, që mund të përdoren vetëm për të blerë një numër shumë të kufizuar mallrash dhe shërbimesh.

² Transaksionet e pagesave nga një ofrues i rrjeteve të komunikimeve elektronike ose shërbimet e ofruara, krahas shërbimeve të komunikimeve elektronike për një pajtimtar të rrjetit ose shërbimit:

- i. për blerje të shërbimeve dixhitale dhe shërbimeve zanore, pavarësisht nga pajisja që përdoret për blerjen ose konsumin e shërbimeve dixhitale dhe pasqyruar në faturën përkatëse; ose

njoftim dhe t'i sigurojnë Bankës së Shqipërisë opinionin vjetor të audituesit ligjor, duke dëshmuar se veprimtaria përputhet me kufijtë e përcaktuar në shkronjën "h", të nenit 4. Përshkrimi i aktiviteteve të njoftuara nga ofruesit e shërbimeve do të vihet në dispozicion të publikut në regjistrin e Bankës së Shqipërisë, të parashikuar në nenin 16, të projektligjit.

Titulli III: Transparenca e kushteve dhe kërkesat për informim për shërbimet e pagesave

Ky titull ka si objektiv krijimin e rregullave të transparencës dhe informimit për shërbimet e pagesave të ofruara në përgjithësi nga ofruesit e shërbimeve të pagesave. Në këtë kuadër vlen të theksohet se, në përjashtim nga titulli II, i cili rregullon institucionet e pagesave, titulli III ashtu si dhe titulli IV, synojnë rregullimin e shërbimeve të ofruara nga të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave, përfshirë këtu bankat, institucionet e parasë elektronike, institucionet e pagesave, Bankën e Shqipërisë dhe autoritetet qendrore ose vendore, në funksionin e ofruesit të shërbimeve të pagesave etj.

Bazuar në nenin 32, të projektligjit, fusha e zbatimit të kërkesave për informim dhe kushtet e transparencës përfshijnë transaksionet individuale të pagesave dhe transaksionet e pagesave të rregulluara nga kontratat tip. Kushtet e përcaktuara në këtë kre do të zbatohen për konsumatorët dhe mikrondërmarrjet. Përfshirja e mikrondërmarrjeve nën të njëjtin regjim me konsumatorët është një opsion, i cili parashikohet nga direktiva. Në këndvështrimin e grupit të punës, duke vlerësuar edukimin dhe përfshirjen e ulët financiare të kësaj kategorie ndërmarrjesh, si dhe aftësitë relativisht të ulëta negociuese krahasuar me ndërmarrjet më të mëdha, trajtimi i njëjtë me konsumatorët do të ndihmonte ndjeshëm në krijimin e një marrëdhënieje besimi të shtuar ndaj institucioneve bankare e financiare dhe në nxitjen e përdorimit të shërbimeve që ato ofrojnë. Duke marrë në konsideratë peshën e lartë që zënë këto biznese në ekonominë shqiptare, përfshirja e tyre financiare do të ndihmonte ndjeshëm në nxitjen e përdorimit të instrumenteve elektronike në Shqipëri. Në të njëjtin nen është shfrytëzuar dhe hapësira e krijuar nga direktiva për përjashtim të pjesshëm të ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha nga regjimi mbrojtës i parashikuar për konsumatorët dhe mikrondërmarrjet. Së fundi, në këtë nen parashikohet dhe zbatimi i kushteve të transparencës, të cilat do të aplikohen në rastin e

ii. realizuar nga ose nëpërmjet një pajisjeje elektronike dhe të pasqyruar në faturën përkatëse, në kuadër të një aktiviteti bamirësie ose për blerjen e biletave;
me kusht që kufizimet për këto transaksione pagese të përcaktohen me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë, dhe në çdo rast kur:

- i. vlera e një transaksioni të vetëm të pagesës nuk e tejkalon shumën prej 7 000 lekë;
- ii. vlera kumulative e pagesave për një pajtimtar të vetëm nuk tejkalon vlerën prej 40 000 lekë në muaj ose;
- iii. në rastet kur pajtimtari rimbush/parapaguan në llogarinë e tij me ofruesin e rrjetit të komunikimeve elektronike ose shërbimit të komunikimeve elektronike, vlera kumulative e transaksioneve të pagesave nuk tejkalon 40 000 lekë në muaj.

transaksioneve ndërkufitare, për pjesën e transaksionit që kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për të rritur efikasitetin në praktikë të projektligjit, ashtu si dhe në direktivë është ruajtur një proporcionalitet për nevojat e informimit të konsumatorëve dhe të mikrondërmarrjeve e, si rrjedhojë, kërkesat për informacion për një transaksion individual pagesash janë të ndryshme nga ato të kryera në bazë të një kontrate tip.

Me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve dhe të mikrondërmarrjeve, neni pasues (neni 33) rregullon tarifat e aplikuara nga ofruesit e shërbimeve të pagesave, ku përcaktohet qartazi se ofruesit e shërbimeve të pagesave tarifojnë klientët e tyre vetëm për dhënien e informacioneve shtesë ose me frekuencë më të shpeshtë nga ato të përcaktuara në projektligj. Ndërkohë që neni 34 përcakton përgjegjësinë e ofruesve të shërbimeve të pagesave për të vërtetuar përmbushjen e detyrimeve ndaj klientëve të tyre të përcaktuara në ligj, për kërkesat për informim.

Së fundi, me qëllim shmangien e mbingarkesave për institucionet, të cilat ofrojnë shërbime pagesash dhe kostove që mbartin këto procedura, projektligji, ashtu si dhe direktiva, parashikon raste përjashtimore (neni 35) nga detyrimet për informim për pagesat me vlerë të vogël, të mbuluar nga një kontratë tip, duke i kufizuar këto nevoja për informim vetëm në karakteristikat kryesore të shërbimit të pagesës. Gjithashtu, duke shfrytëzuar hapësirat e krijuara nga Direktiva (opsionet e dhëna), në projektligj është parashikuar mundësia që Banka e Shqipërisë t'i reduktojë ose t'i dyfishojë këto vlera, në akte nënligjore.

Lidhur me transaksionet e pagesave individuale, sipas nenit 36 e në vijim, informacioni duhet të përqendrohet në informacione thelbësore, të cilat i nevojiten përdoruesit të shërbimeve të pagesave për kryerjen e një pagese. Vlen të theksohet se ky informacion duhet ofruar me iniciativën e ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe jo me kërkesën e klientëve. Megjithatë, konsumatori ose mikrondërmarrja gëzon të drejtën të kërkojë informacionin e nevojshëm në format *hard copy* ose në një mjet tjetër të qëndrueshëm komunikimi.

Informacioni në lidhje me pagesat individuale, sipas projektligjit, ndahet në informacion paraprak (nenet 37 dhe 38) dhe informacione pas iniciimit të pagesës, deri pas ekzekutimit të pagesës (nenet 39-42), ku përcaktohen nevojat për informim të paguesit dhe përfituesit, si dhe detyrimet e të gjithë ofruesve të shërbimeve të përfshirë në procesimin e një pagese.

Ndërkohë, nevojat për informim për pagesat, të cilat rregullohen nga një kontratë tip, parashikohen në nenet 43-51 të projektligjit. Në lidhje me të drejtat

e konsumatorëve dhe mikrondërmarrjeve, projektligji parashikon të drejtën e marrjes së informacioneve të nevojshme parakontraktore pa pagesë. Gjithashtu, ata gëzojnë të drejtën të kërkojnë informacionet paraprake të përcaktuara në nenin 45, si dhe kontratën tip, pa pagesë në çdo kohë gjatë marrëdhënies kontraktuale, duke krijuar mundësinë e vlerësimit të shërbimeve të ofruara nga ana e konsumatorëve dhe mikrondërmarrjeve, si dhe analizimin e të drejtave dhe detyrimeve në rastin e ndonjë mosmarrëveshjeje, për të verifikuar të drejtat dhe detyrimet e tyre kontraktuale, duke ruajtur kështu një nivel të lartë të mbrojtjes së konsumatorit.

Projektligji parashikon se konsumatorët dhe mikrondërmarrjet duhet të marrin informacion bazë për transaksionet e pagesave të ekzekutuara, pa pagesë. Në mënyrë të ngjashme, informacionet e mëvonshme mbi transaksionet e pagesave, sipas dispozitave të kontratës tip, duhet të sigurohen në baza mujore, pa pagesë. Megjithatë, duke marrë parasysh rëndësinë e transparencës në çmimet dhe nevojat e ndryshme të konsumatorëve, projektligji parashikon edhe mundësinë e kërkesave të mëtejshme për informacion kundrejt një pagese.

Për të lehtësuar mundësinë e përzgjedhjes së ofruesve të shërbimeve të pagesave, projektligji, nëpërmjet nenit 48, parashikon mundësinë që përdoruesit e shërbimeve të pagesave të përfundojnë/zgjidhin një kontratë tip pa mbartur kosto për ta, me përjashtim të rasteve kur kontrata përfundohet/zgjidhet në një periudhë më të shkurtër se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të saj. Në këto kushte, ofruesit e shërbimeve të pagesave mund të aplikojnë tarifa, për mbulimin e kostove të shkaktuara për shkak të ndërprerjes së kontratës tip nga ana e konsumatorit/mikrondërmarrjes. Për më shumë, projektligji parashikon dhe afatet kohore që duhet të respektojnë palët për njoftimin e ndërprerjes së saj (1 muaj për përdoruesit e shërbimeve të pagesave dhe 2 muaj për ofruesit e shërbimeve të pagesave).

Titulli IV: Të drejtat dhe detyrimet për ofrimin e përdorimin e shërbimeve të pagesave

Titulli IV, i projektligjit, rregullon të drejtat dhe detyrimet midis ofruesve të shërbimeve, përfshirë këtu dhe ndërmjetësit, të cilët mundësojnë kryerjen e një pagese, dhe përdoruesit e shërbimeve, me qëllim rritjen e efikasitetit të shërbimeve nëpërmjet rregullimit të tarifave të aplikuara, kohës së ekzekutimit, si dhe nxitjen e sigurisë dhe të besueshmërisë në procesimin e pagesave me instrumente të ndryshme.

Fusha e zbatimit e këtij titulli është e njëjtë me atë të titullit III dhe ka në fokusin e tij qendror konsumatorët dhe mikrondërmarrjet, sipas nenit 54, të projektligjit. Në të njëjtin nen është shfrytëzuar dhe hapësira e krijuar nga direktiva për përjashtim të pjesshëm të ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të

mëdha nga regjimi mbrojtës i parashikuar për konsumatorët dhe mikrondërmarrjet, si dhe përjashtimin e tyre nga zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve (ZAM).

Në nenin 55, të projektligjit, trajtohet mënyra e tarifimit të shërbimeve të pagesave dhe ashtu si dhe direktiva, është përcaktuar se parimi “*share*” - ndarja e komisioneve ndërmjet paguesit dhe përfituesit - do të zbatohet në transaksionet brenda vendit. Bazuar në eksperiencën evropiane, respektimi i kësaj mënyre lehtëson procesimin automatik të pagesave. Megjithatë, bazuar në preambulën e direktivës, kjo dispozitë nuk bie ndesh me mundësinë që tarifat të jenë 0 (zero) nëse përfituesi i pagesës nuk tarifohet për kreditimin e llogarisë, duke krijuar kështu hapësira për vijimin e zbatimit të vendimit³ për mënyrën, tarifat e aplikuara nga bankat për pagesat e procesuara në sistemin AIPS dhe AECH. Gjithashtu, në këtë nen, bazuar në hapësirat e krijuara nga direktiva është parashikuar dhe mundësia e tarifimit vetëm të përfituesit për instrumente të caktuara, duke mundësuar kështu vijimin e praktikave të ndjekura deri më tani nga tregu lidhur me pagesat me kartë në terminale POS ose pagesat e faturave të kompanive utilitare, ku komisionet i mbahen përfituesit. Për më shumë, kjo dispozitë krijon mundësinë e zbatimit në të ardhmen të rregullores së Bashkimit Evropian nr.2015/751 për *interchange fees* për transaksionet me kartë.

Megjithatë, me qëllim promovimin e instrumenteve me vlerë të vogël dhe hyrjen e aktorëve të rinj në treg, projektligji (neni 56) parashikon disa përjashtime në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e palëve për këto kategori pagesash, duke krijuar kështu një regjim lehtësues.

Autorizimi i pagesave është një koncept tejet i rëndësishëm në procesin e kryerjes së pagesës. Në këto kushte, kreu II (nenet 57-70), i këtij titulli, i dedikohet rregullimit të këtij momenti. Një procedurë kyçe për materializimin e autorizimit të pagesës është dhënia dhe tërheqja e pëlqimit, duke krijuar kështu parakushtet e nevojshme për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve kundrejt ekzekutimit ose jo të saj.

Një moment tjetër i rëndësishëm i projektligjit është dhe krijimi i hapësirave për emetim kartash edhe nga institucionet e pagesave. Emetimi i kartave ka qenë një ekskluzivitet i institucioneve bankare jo vetëm në tregun shqiptar, por dhe më gjerë. Duke konsideruar zhvillimet e fundit, zgjerimi i aktorëve në treg do të mundësojë nxitjen e konkurrencës dhe si rrjedhojë rritjen e efikasitetit të shërbimeve të ofruara. Me qëllim mbështetjen e përdorimit të kartave, si një nga

³ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.12, datë 07.03.2011 "Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe (AIPS) dhe në Rregulloren për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)".

instrumentet më të përdorura në përditshmërinë e qytetarëve, është krijuar funksioni i ofruesit të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë, i cili lehtëson zbatimin e mënyrave dhe kanaleve të reja inovative të pagesave duke mundësuar emetimin e kartave edhe nga ofrues shërbimesh të pagesave, të cilët nuk zotërojnë llogaritë e klientëve (neni 58).

Vlen të shpjegohet se përdorimi i kartës ose i instrumentit të pagesave të bazuara në kartë⁴ për të bërë një pagesë, bazohet në gjenerimin e një mesazhi që konfirmon disponueshmërinë e fondeve dhe në dy transaksione pagesash. Transaksioni i parë zhvillohet ndërmjet emetuesit dhe ofruesit të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë, ndërsa i dyti, zakonisht një debitim direkt, kryhet ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave për shërbimin e llogarive të pagesit dhe emetuesit. Të dy këto lloje transaksionesh, sipas projektligjit, duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si çdo transaksion tjetër ekuivalent. Ofruesit e shërbimeve të pagesave që emetojnë instrumente të pagesave të bazuara në kartë duhet të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe i nënshtrohen të njëjtave detyrime, pavarësisht nëse janë ose nuk janë ofruesit e shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë të pagesit, veçanërisht në aspektin e përgjegjësisë dhe detyrimeve ndaj aktorëve të ndryshëm në zinxhirin e pagesave. Megjithatë, në projektligj, duke ndjekur parashikimin e direktivës për këtë çështje, detyrimet e ofruesve të shërbimeve kufizohen vetëm në rastet kur llogaritë janë të aksesueshme nga interneti.

Në të njëjtën linjë, neni 59 rregullon aksesin në llogarinë e pagesës nga ofruesi i shërbimeve të inicimit të pagesës me qëllim realizimin e pagesave nëpërmjet një transferte krediti elektronike. Rregullimi i aksesimit të informacionit për disponueshmërinë e fondeve për këtë qëllim, në mënyrë të sigurt ndihmon në realizimin e këtyre pagesave për realizimin e tregtisë elektronike jo vetëm nëpërmjet kartave, por edhe transfertave elektronike, duke nxitur kështu përdorimin e instrumenteve elektronike në ekonominë vendase dhe si rrjedhojë reduktimin e *cash-it*, i cili mbart kosto për aktorët e përfshirë në transaksion, por njëkohësisht mund të stimulojë informalitetin.

Së fundi, neni 60 rregullon aksesimin dhe përdorimin e informacionit për llogarinë e pagesës në rastin e shërbimit të informimit të llogarisë duke u mundësuar konsumatorëve dhe bizneseve të kenë një pamje të përgjithshme mbi gjendjen e tyre financiare, për shembull, duke u mundësuar konsumatorëve të shikojnë llogaritë e ndryshme që mund të kenë me një ose më shumë banka në një vend të vetëm dhe të kategorizojnë shpenzimet e tyre sipas tipologjive të ndryshme (ushqim, energji, qira, kohë e lirë etj.), duke i ndihmuar kështu në buxhetimin dhe planifikimin financiar.

⁴ Si rasti i kartave virtuale të inkomporuara në celular.

Neni 61, me qëllim rregullimin e mëtejshëm të aksesit të garantuar për emetimin e kartave nga një ofrues i shërbimeve të pagesave i cili nuk zotëron llogarinë e përdoruesit (neni 58), iniciimi i pagesave nga ofruesi i shërbimeve të inicimit të pagesës (neni 59) dhe ofrimin e shërbimit të informimit të llogarisë (neni 60), krijon rregulla mbi kufijtë e përdorimit të instrumentit të pagesës dhe aksesit në llogaritë e pagesës nga ofruesi i shërbimeve të pagesave.

Detyrimi për të siguruar kredencialet e personalizuar është i një rëndësie të veçantë për mbrojtjen e fondeve të përdoruesit të shërbimeve të pagesave dhe për të kufizuar rreziqet që lidhen me mashtrimin dhe aksesimin e paautorizuar në llogarinë e pagesave sipas nenit 62, të projektligjit. Megjithatë, termat dhe kushtet ose detyrimet e tjera të vendosura nga ofruesit e shërbimeve të pagesave për përdoruesit e shërbimeve të pagesave lidhur me ruajtjen e kredencialeve të personalizuar të sigurisë nuk duhet, në asnjë mënyrë, të pengojnë përdoruesit e shërbimeve të pagesave të përfitojnë nga shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve të pagesave, si për shembull nga ofruesit e shërbimit të iniciimit të pagesës dhe ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë, ose mosekzekutimin e një pagese të autorizuar (neni 63).

Sipas nenit 64, për të zvogëluar rreziqet dhe pasojat e transaksioneve të pagesave të paautorizuara ose të kryera në mënyrë të gabuar, përdoruesi i shërbimeve të pagesave duhet të informojë ofruesin e shërbimeve të pagesave sa më shpejt që të jetë e mundur për çdo kundërshtim, me kusht që ofruesi i shërbimeve të pagesave të ketë përmbushur detyrimet e tij të informacionit të përcaktuara në titullin III, të projektligjit.

Në bazë të nenit 65, në rastin kur përdoruesi i shërbimeve të pagesave mohon të ketë autorizuar ekzekutimin e një transaksioni pagese ose pretendon se transaksioni i pagesës nuk është ekzekutuar në mënyrë korrekte, është detyrim i ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe ndërmjetësve të përfshirë në transaksion për të vërtetuar të kundërtën. Gjithashtu, në projektligj parashikohet një ndarje proporcionale e detyrimeve ndërmjet ofruesve të ndryshëm të shërbimeve të përfshirë në procesimin e pagesës.

Në vijim, neni 66 rregullon detyrimet dhe përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve të pagesave në rastin e transaksioneve të paautorizuara. Më konkretisht, ofruesi duhet të kthejë menjëherë shumën e transaksionit të pagesës, duke e rikthyer llogarinë e debituar të pagesës në gjendjen në të cilën ajo do të kishte qenë nëse transaksioni i paautorizuar i pagesës nuk do të kishte ndodhur. Megjithatë, kur ekzistojnë dyshime objektive, të cilat i komunikohen Bankës së Shqipërisë për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet të jetë në gjendje të kryejë, brenda një kohe të arsyeshme, një hetim para rimbursimit të pagesës. Për të mbrojtur pagesin, sipas projektligjit, datëvaluta

për kreditimin e llogarisë nuk duhet të jetë më vonë se data kur shuma është debituar.

Megjithatë, sipas nenit 67, të projektligjit, në mënyrë që të incentivohet/nxitet përdoruesi për të përmbushur detyrimet e parashikuara në projektligj lidhur me njoftimin pranë ofruesit të shërbimeve të pagesave të çdo vjedhjeje ose humbjeje të një instrumenti pagese, është parashikuar që përdoruesi duhet të jetë përgjegjës për dëmin e shkaktuar vetëm për një shumë të kufizuar, me përjashtim të rasteve kur përdoruesi i shërbimeve të pagesave ka vepruar me mashtrim ose me pakujdesi të rëndë. Në këtë kontekst, në projektligj është parashikuar që përdoruesi do të jetë përgjegjës për një shumë maksimale prej 5 000 lekësh. Megjithatë, në këtë dispozitë parashikohen edhe rastet përjashtimore kur përdoruesi nuk është i vetëdijshëm për humbjen, vjedhjen ose keqpërdorimin e instrumentit të pagesës. Gjithashtu, në këtë nen parashikohet që përdoruesit, pasi kanë përmbushur detyrimet e tyre për njoftim, nuk mund të jenë përgjegjës për të mbuluar pagesa të paautorizuara.

Ashtu si dhe direktiva, projektligji (neni 68) synon të rrisë mbrojtjen e konsumatorit në rastet e transaksioneve të pagesave të bazuara në karta kur shuma e saktë e transaksionit nuk dihet në momentin kur paguesi jep pëlqimin për të ekzekutuar transaksionin e pagesës. Shembuj të tillë mund të jenë rastet e vetëshërbimit në karburante, pagesat për marrjen me qira të një makine ose rezervimet e hoteleve. Në rastet e sipërcituara, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit duhet të jetë në gjendje të bllokojë fondet në llogarinë e pagesës së paguesit vetëm nëse paguesi ka dhënë pëlqimin për shumën e saktë të fondeve që duhet të bllokohen dhe këto fonde duhet të lirohen/zhblllokohen pa vonesa të panevojshme pas marrjes së informacionit për shumën e transaksionit të pagesës dhe jo më vonë se menjëherë pas pranimi të urdhërpagesës. Parashikimi i fundit synon të shmangë praktika të hasura gjatë përdorimit të kartave për rezervime të ndryshme, ku ofruesi i shërbimeve të pagesave mban të bllokuar shumën deri në një muaj, pavarësisht faktit se pagesa është kryer.

Ndërkohë, nenet 69 dhe 70 rregullojnë debitimin direkt bazuar në një skemë debitimi direkt si dhe debitimet direkte të gjeneruara nga pagesa me kartë, siç u shpjegua në nenin 58. Parimi kryesor i paraqitur në këto nene për funksionimin e skemës së debitimit është që mandati për ekzekutimin e një debitimi direkt është dhënë nga paguesi tek përfituesi i pagesës dhe, së bashku me ndryshimet ose anulimet e mëvonshme, ruhet nga përfituesi. Megjithatë, bazuar në preambulën e direktivës shpjegohet se mandati mund të ruhet gjithashtu edhe nga një palë e tretë në emër të përfituesit. Ashtu si dhe direktiva, neni 70, me qëllim mbështetjen sa më të gjerë të përdorimit të instrumentit dhe për të siguruar një nivel të lartë mbrojtjeje të konsumatorit, është parashikuar e drejta e pakushtëzuar për një rimbursim për pagesat e autorizuara me debitimet direkte të kryera nëpërmjet një skeme.

Për planifikimin financiar dhe përmbushjen e detyrimeve të pagesave në kohën e duhur, konsumatorët dhe ndërmarrjet duhet të kenë siguri për kohëzgjatjen e ekzekutimit të urdhërpagesës. Në këtë kuadër, kreu III përcakton momentin kur të drejtat dhe detyrimet e palëve hyjnë në fuqi.

Më konkretisht, kreu III i këtij titulli rregullon ekzekutimin e pagesës. Nga pikëpamja e planifikimit financiar dhe përmbushjes së detyrimeve të pagesave në kohën e duhur, koha e ekzekutimit të pagesës është tejet e rëndësishme për konsumatorët dhe ndërmarrjet. Në këto kushte, projektligji, në linjë edhe me direktivën, përcakton momentin kur të drejtat dhe detyrimet hyjnë në fuqi (përcaktimi i momentit të pranimi të urdhërpagesës për instrumente të ndryshme - neni 71).

Momenti i pranimi të urdhërpagesës konsiderohet momenti kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të pagesit pranon urdhërpagesën për t'u debituar nga llogaria e pagesit, duke përfshirë këtu dhe rastet kur ofruesi i shërbimeve të pagesave ka pasur mundësinë ta marrë atë përmes mjeteve të komunikimit të dakordësuara në kontratën e shërbimit të pagesës. Vlen të theksohet se ky moment duhet të konsiderohet i pavarur nga çdo përfshirje paraprake në proces, si për shembull për krijimin dhe transmetimin e urdhërpagesës ose, rastet që lidhen me kontrollin mbi disponueshmërinë e fondeve ose informacionin mbi përdorimin e numrit të identitetit personal ose dhënien e premtimit të pagesës. Gjithashtu, dita ose momenti kur një përfitues i dërgon urdhërpagesat tek ofruesi i shërbimeve të pagesave për mbledhjen, si për shembull të pagesave me kartë ose të debitimeve direkte ose kur përfituesit i është dhënë një parafinancim nga ofruesi i shërbimeve të pagesave me anë të një kredie të kushtëzuar në llogari, ky moment nuk konsiderohet si moment i pranimi të urdhërpagesës.

Përdoruesit nevojitet t'i garantohet një ekzekutim urdhërpagese nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk ka bazë kontraktuale ose statutore për refuzim. Nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave refuzon një urdhërpagesë, refuzimi dhe arsyeja e refuzimit duhet t'i komunikohen përdoruesit të shërbimit të pagesave sa më shpejt të jetë e mundur, në përputhje me këtë projektligj (neni 72). Në rastin e tarifimit nga ofruesi i shërbimit për refuzimin, ky tarifim duhet të jetë i përcaktuar objektivisht dhe në nivele sa më të ulëta.

Në terma të ekzekutimit të pagesës rregullohet dhe momenti i parevokueshmërisë së pagesës (neni 73). Më konkretisht, duke pasur parasysh shpejtësinë me të cilën operojnë sistemet moderne të pagesave plotësisht automatike, është e nevojshme të përcaktohet një afat i qartë për revokimet e pagesave. Megjithatë, momenti i parevokueshmërisë varion për instrumente të ndryshme pagese përfshirë këtu dhe debitimin direkt. Revokimi, në këtë kontekst, duhet të zbatohet vetëm për marrëdhëniet ndërmjet një përdoruesi të

shërbimeve të pagesave dhe një ofruesi të shërbimeve të pagesave, duke mos cenuar në këtë mënyrë parevokueshmërinë dhe karakterin përfundimtar të transaksioneve të pagesave në sistemet e pagesave.

Është thelbësore që shuma e pagesës të transferohet e plotë nga paguesi te përfituesi. Kjo mbështet përpunimin automatik të pagesave, si edhe garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj palëve të treta. Në këto kushte, neni 74 i projektligjit garanton sa më sipër, si dhe përcakton se asnjë ndërmjetës në procesimin e pagesës nuk redukton shumën e dërguar për të mbajtur komisionet përkatëse. Megjithatë, dërguesi i pagesës mund të bjerë dakord me ofruesin e shërbimeve të pagesave, për t'i lejuar këtij të fundit të zbresë tarifat e veta. Me qëllim që t'i mundësojë përfituesit të pagesës verifikimin e kryerjes korrekte të pagesës, informacioni i disponueshëm duhet të tregojë jo vetëm shumën e plotë të fondeve të transferuara, por edhe shumën e çdo tarife që është zbritur.

Me qëllim nxitjen e efikasitetit të pagesave në projektligj, nëpërmjet nenit 76, është parashikuar se të gjitha urdhërpagesat kombëtare të iniciuara nga paguesi në lekë dhe në euro, duhet t'i nënshtrohen një kohe maksimale ekzekutimi T+1 (në ditën pasardhëse të punës). Nga ana tjetër, duke njohur vështirësitë e procesimit të pagesave në format *hard copy*, neni 76 lejon mundësinë e shtyrjes së ekzekutimit të këtyre lloje transaksionesh me një ditë pune. Për të gjitha pagesat e tjera, siç janë pagesat e nisura nga ose përmes një paguesi, duke përfshirë debitime direkte dhe pagesa me karta, në mungesë të një marrëveshjeje të qartë midis ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe paguesit për të vendosur një kohë më të gjatë ekzekutimi, duhet të aplikohet i njëjti afat kohor. Ndërkohë, projektligji parashikon për transaksionet e pagesave me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, një periudhë jo më të gjatë ekzekutimi se T+4 edhe në rastin kur palët bien dakord për një periudhë ndryshe/tjetër nga sa u përmend më lart.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë duke shfrytëzuar hapësirat e krijuara nga Direktiva si dhe për zbatimin e mëtejshëm të rregulloreve për sistemin AIPS dhe AECH, nëpërmjet nenit 80 të projektligjit mund të zbatojë një afat ekzekutimi për pagesat në lekë brenda vendit T (brenda ditës).

Neni 77 rregullon përkatësisht rastin e mungesës së një llogarie nga ana e përfituesit, ku ofruesi i shërbimeve të pagesave merr fondet për llogari të përfituesit sipas afateve të përcaktuara më lart. Ndërkohë, neni 78 përcakton se paraja fizike e depozituar në llogari duhet të bëhet menjëherë e disponueshme për konsumatorët edhe për mikrondërmarrjet, ndërkohë për ndërmarrjet e tjera përcaktohet midis palëve.

Nenet 81 deri në 85 rregullojnë detyrimet e palëve të përfshira në transaksion për mosekzekutimin, ekzekutimin e gabuar ose të vonuar të pagesave.

Funksionimi i qëndrueshëm dhe efikas i sistemit të pagesave ndikohet drejtpërdrejt nga aftësitë e ofruesit të shërbimeve të pagesave për të ekzekutuar pagesat në mënyrën e duhur dhe duke minimizuar rreziqet. Nën këtë supozim, rregullimi i sipërcituar bazohet në parimin se përgjegjësinë për ekzekutimin ose jo të një pagese të pranuar nga paguesi duhet ta mbartë ofruesi i shërbimeve të pagesave dhe ndërmjetësit e përfshirë në transaksion. Më konkretisht, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, përfshirë këtu ofruesin e shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë, dhe, kur është e përshtatshme, ofruesin e shërbimit të inicimit të pagesave, duhet të marrin përgjegjësinë për ekzekutimin korrekt të pagesave, duke përfshirë, në veçanti, shumën e plotë të transaksionit të pagesës dhe kohën e ekzekutimit, si dhe përgjegjësinë e plotë për çdo dështim nga palët e tjera në zinxhirin e pagesave deri në llogarinë e përfituesit me përjashtim të rasteve, të situatave jo normale dhe të paparashikuara të përcaktuara në nenin 86 të projektligjit.

Si rezultat i kësaj përgjegjësie, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit duhet kur shuma e plotë nuk kreditohet ose kreditohet me vonesë tek ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit, të korrigjojë transaksionin e pagesës ose pa vonesa të panevojshme të rimbursojë paguesin për shumën përkatëse të transaksionit pa aplikuar asnjë tarifë për këtë veprim. Për shkak të përgjegjësisë së ofruesit të shërbimeve të pagesave, paguesi ose përfituesi nuk duhet të ngarkohen me kosto që lidhen me pagesën e gabuar.

Lidhur me ekzekutimin e pagesës në mënyrë të gabuar, si rrjedhojë e dhënies së kodit unik të identifikimit të pasaktë (neni 81) nga ana e paguesit, ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk mbart përgjegjësi, megjithatë duhet të bashkëpunojë për rimarrjen e fondeve nëpërmjet komunikimit të informacioneve përkatëse.

Në nenin 87, të projektligjit, duke marrë parasysh se procesimi i pagesave kërkon dhe përdorim të të dhënave personale, përcaktohet qartazi nevoja për zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në çdo proces dhe vetëm pasi kanë marrë pëlqimin e përdoruesit të shërbimeve të pagesave.

Një kre i veçantë në projektligj i dedikohet edhe administrimit të rrezikut operacional dhe të sigurisë, si dhe autentifikimit të klientëve.

Më konkretisht, neni 88 parashikon detyrimin që ofruesit e shërbimeve të pagesave të marrin masat e duhura për zbutjen e rrezikut operacional dhe të krijojnë sisteme kontrolli të përshtatshme për administrimin e tij dhe të sigurisë që lidhet me shërbimet e pagesave të ofruara. Njëkohësisht, këta ofrues duhet të paraqesin pranë Bankës së Shqipërisë, mbi baza vjetore, ose siç përcaktohet nga kjo e fundit, një vlerësim për rrezikun operacional dhe rrezikun e sigurisë që

lidhet me shërbimet që ata ofrojnë, si dhe mbi mjaftueshmërinë e masave për zbutjen e tij dhe të sistemeve të kontrollit të krijuara për administrimin e këtyre rreziqeve.

Në rastin e ndodhjes së një incidenti madhor operacional ose të sigurisë, neni 89 parashikon detyrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave për njoftim pa vonesa të pajustificuara të Bankës së Shqipërisë, e cila duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur sigurinë e menjëhershme të sistemit financiar. Në rastet kur ky incident ndikon në interesat financiare të përdoruesve të shërbimeve të pagesave, ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet t'i informojë këta të fundit mbi incidentin dhe të gjitha masat që ata mund të marrin për të zbutur efektet e padëshiruara të incidentit. Ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet t'i paraqesin mbi baza periodike Bankës së Shqipërisë, të dhëna statistikore për mashtrimet, në lidhje me mjetet e ndryshme të pagesës.

Neni 90 përcakton rastet kur ofruesit e shërbimeve të pagesave zbatojnë verifikimin e thelluar të klientit, si dhe detyrimin që këta ofrues të marrin masat e nevojshme për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe integritetit të kredencialeve të personalizuar të sigurisë, të përdoruesve të shërbimit të pagesave.

Së fundi, një çështje tejet e rëndësishme e trajtuar në projektligj është dhe krijimi i procedurave të shqyrtimit alternativ të mosmarrëveshjeve. Në këtë kuadër, bazuar në rekomandimet e direktivës, si një hap të parë drejt mbrojtjes së konsumatorëve, në nenin 92, parashikohet krijimi i një njësie të veçantë (ZAM) brenda Bankës së Shqipërisë, e cila do ketë detyrën e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve të lindura ndërmjet klientëve dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave. Është vlerësuar që kjo njësi të shqyrtojë mosmarrëveshjet vetëm të konsumatorëve dhe të mikrondërmarrjeve, në cilësinë e klientit, duke përjashtuar mosmarrëveshjet e biznesit. Parashikimet ligjore janë hartuar në përputhje të plotë me ato të direktivës, por edhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit, pas ndryshimeve të fundit.

Banka e Shqipërisë ka detyrimin të krijojë ZAM-në dhe të miratojë procedurat përkatëse që do të nevojiten për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të cilat do të publikohen, në mënyrë që ofruesit dhe klientët e tyre të jenë në dijeni të plotë të hapave që duhen ndjekur përpara se të fillojë shqyrtimi i mosmarrëveshjeve.

Nga ana tjetër, neni 93, i projektligjit, trajton të gjitha detyrimet dhe afatet përkatëse që kanë ofruesit kundrejt klientëve të tyre në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë rrugës gjyqësore.

Titulli V: Kundërvajtjet administrative, sanksionet dhe ankimet

Titulli V përbëhet nga dy krerë. Kreu I trajton kundërvajtjet administrative dhe sanksionet, dhe kreu 2 trajton ankimet: ankimin administrativ dhe ankimin gjyqësor.

Më konkretisht:

Neni 94 i, projektligjit, përcakton sanksionet që Banka e Shqipërisë, si autoritet mbikëqyrës, ka të drejtë të vendosë ndaj institucionit të pagesave dhe/ose kundrejt atyre që efektivisht kontrollojnë dhe administrojnë veprimtarinë e institucionit të pagesave, në rast konstatimi shkeljesh të dispozitave të këtij ligji. Këto sanksione përcaktohen si kundërvajtje administrative, me qëllim ndërprerjen e shkeljes dhe/ose ndreqjen e pasojave të shkeljes.

Trajtimi në ligj, dhe jo në një akt nënligjor, i sanksioneve administrative është një detyrim që rrjedh nga ligji nr.10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”⁵. Në nenin 94 parashikohet se për çdo shkelje konkrete të dispozitave të këtij ligji ka një gjobë, masa e së cilës përcaktohet duke vlerësuar kriteret e përcaktuara në pikën 8, të këtij neni. Përveç gjobave janë përcaktuar edhe sanksione të tjera, të tilla si revokimi ose pezullimi i licencës në raste të caktuara. Gjobat janë tituj ekzekutivë dhe me ekzekutimin e tyre ngarkohet Zyra e Përmbartimit. Ato arkëtohen për llogari të Bankës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin “Për kundërvajtjet administrative”.

Në nenin 95 është parashikuar detyrimi i Bankës së Shqipërisë të publikojë në faqen zyrtare të internetit sanksionet e vendosura për shkelje të dispozitave të këtij ligji. Publikimi bëhet menjëherë pasi personi, ndaj të cilit është vendosur sanksioni, të jetë informuar për atë sanksion, duke përfshirë informacione për llojin e natyrën e shkeljes dhe identitetin e individit apo personit juridik mbi të cilin është vendosur sanksioni. Në rastin e publikimit të sanksioneve, kundër të cilave është bërë ankesë, Banka e Shqipërisë publikon edhe informacionin për statusin e asaj ankese dhe rezultatin e saj.

Është parashikuar që publikimi sipas këtij neni të qëndrojë në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë, maksimumi një vit, dhe, në çdo rast, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Përjashtim nga publikimi i sanksioneve mund të jetë vetëm rasti kur Banka e Shqipërisë gjykon se publikimi rrezikon seriozisht stabilitetin e tregjeve financiare ose i shkakton dëm joproporcional palëve të përfshira.

Në nenin 96 të projektligjit parashikohet procedura e ankimit administrativ për çdo institucion pagese, i cili pretendon se të drejtat dhe interesat e ligjshme të tij janë cenuar nga akte administrative të nxjerra në zbatim të dispozitave të këtij

⁵ Neni 10, Masa e gjobës: “Masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë.”

ligji. Subjekti ka të drejtë të kryejë ankim administrativ tek Guvernatori brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e aktit. Ankimi administrativ paraqitet në formën dhe shqyrtohet brenda afateve të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe është kusht paraprak për kundërshtimin e vendimit në gjykatë. Ankimi administrativ nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë.

Parashikimet e këtij neni kanë synuar të mbajnë një qëndrim të unifikuar me dispozita të njëjta të ligjit për Bankën e Shqipërisë, të ligjit për bankat, të ligjit për shoqëritë e kursim-kreditit, si dhe ligjit për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, pasi theksojmë se të pikës 2, të nenit 72, të ligjit për Bankën e Shqipërisë parashikohet se aktet e Bankës së Shqipërisë do të zbatohen pa kufizim, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

Në nenin 97 të projektligjit parashikohet se institucioni i pagesës, pasi ka ezauruar ankimin administrativ mund të ankohet në Gjykatën Administrative të Apelit brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Parashikimi i Gjykatës së Apelit, si gjykatë kompetente për shqyrtimin e ankimit gjyqësor synon të mbajë një qëndrim të unifikuar me pikën 1, të nenit 72, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, si dhe me pikën 6, të nenit 93, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të cilët përcaktojnë Gjykatën e Apelit si gjykatë të shkallës së parë për vendimet që merr Banka e Shqipërisë. Ky parashikim është në përputhje edhe me pikën 2, të nenit 10, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ku përcaktohet se Gjykata Administrative e Apelit shqyrton në shkallë të parë, edhe në rastet e parashikuara me ligj.

Ankimi gjyqësor kundër Bankës së Shqipërisë është parashikuar edhe në rast se kjo e fundit nuk ka nxjerrë një akt që ka pasur detyrimin për të rregulluar një çështje të caktuar. Kjo dispozitë është përshtatur në përputhje me përcaktimin e pikës 2, të nenit 25, të direktivës.

Titulli VI: Dispozita të fundit dhe kalimtare

Titulli VI, i projektligjit, synon të rregullojë çështjet: rishikimi i ligjit, dispozita kalimtare, aktet nënligjore që duhen miratuar nga Banka e Shqipërisë në zbatim të ligjit, si dhe së fundmi hyrjen në fuqi të tij.

Në nenin 98, të projektligjit, parashikohet detyrimi për bashkëpunim/konsultim reciprok të institucioneve në rast ndryshimi/rishikimi të ligjit, por edhe të

iniciativave të tjera legislative që lidhen me fushëveprimin e këtij projektligji. Ky detyrim është reciprok, si për Bankën e Shqipërisë në rast se mendon të ndryshojë ligjin, ashtu edhe për institucionet e tjera në rast se gjykohen të nevojshme ndryshime në ligj apo në legjislacionin e ndërlidhur me këtë projektligj.

Në nenin 99 të projektligjit synohet të rregullohet regjimi kalimtar për bankat dhe subjektet financiare jo banka, veprimtaria e të cilave preket që nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Subjektet financiare jo banka dhe institucionet e parasë elektronike të licencuara nga Banka e Shqipërisë, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave konsiderohen si të licencuara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe do të klasifikohen si “institucione të pagesave”.

Ofruesit e shërbimeve të pagesave të licencuar nga Banka e Shqipërisë, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, duhet të marrin masat, të organizojnë veprimtarinë dhe strukturën e brendshme, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Subjektet e sipërcituara duhet të plotësojnë kërkesat e këtij ligji brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose, në rast të kundërt, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të revokojë licencën e tyre.

Së fundmi, është parashikuar që ligji të hyjë në fuqi 6 muaj pas publikimit në “Fletoren zyrtare” dhe Bankës së Shqipërisë i lihet një afat 1-vjeçar nga hyrja në fuqi e ligjit, për të miratuar aktet nënligjore që kërkohen në zbatim të ligjit. Këto afate janë përcaktuar duke marrë në konsideratë, së pari, kohën që u nevojitet institucioneve për t’u përshtatur me kërkesat e reja që do të vendosë ky projektligj. Edhe vetë direktiva u la shteteve anëtare një periudhë të gjatë kohore, përafërsisht 2 vjet e pak, për ta adaptuar atë në legjislacionin vendas, pavarësisht se shtetet anëtare kaluan në PSD2 direkt nga PSD1.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E PROJEKTLIGJIT

Institucioni që ngarkohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me zbatimin e këtij projektligji është Banka e Shqipërisë, e cila ngarkohet të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të tij.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT

Projektligji është hartuar nga një grup i posaçëm pune, i krijuar në Bankën e Shqipërisë, në bashkëpunim me ekspertë të Bankës Qendrore të Italisë dhe Bankës Botërore. Projekti është diskutuar gjerësisht me përfaqësues të bankave, subjekteve jo banka, shoqëritë e kursim-kreditit dhe aktorë të tjerë të tregut.

Sugjerime në vijim të asistencës për pajtueshmërinë me direktivën dhe praktikën më të mira:

Projektligji i propozuar mundohet të akomodojë edhe nevojat për shtrirje gjithëpërfshirëse të sistemit bankar dhe atij financiar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim nxitjen e përfshirjes financiare, duke lejuar edhe Bankat të operojnë me agentë, në një linjë e si trajtim i barabartë me këtë të drejtë të institucioneve financiare jo banka dhe institucionet e parasë elektronike. Në këtë kuadër, asistenca ndërkombëtare ka sugjeruar edhe heqjen e marrëdhënies ekskluzive të agentëve (parashikuar në nenin 951, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë), me qëllim nxitjen e konkurrencës në tregun e shërbimeve të pagesave.

Projektligji, me qëllim përputhshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë) ka devijuar nga praktika e Direktivës 2015/2366 BE, që synon ta përafrojë në lidhje me afatin për ngritjen e një pretendimi nga përdoruesi i shërbimit lidhur me transaksion pagese të paautorizuar ose të ekzekutuar gabimisht (konkretisht, neni 1022, i Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë, parashikon 6 (gjashtë) muaj, ndërkohë direktiva parashikon 13 (trembëdhjetë) muaj pas datës së debitimit).

Pas finalizimit të projektligjit, Banka e Shqipërisë ka publikuar në faqen e saj zyrtare për konsultim publik dokumentin. Gjithashtu, projektligji është dërguar për opinion pranë bankave, institucioneve financiare jo banka, shoqërive të kursim-kreditit, si dhe operatorit të skemës kombëtare të pagesave me kartë. Komentet janë analizuar nga grupi i punës dhe aty ku është konsideruar e rëndësishme, sugjerimet janë reflektuar në projektligj. Komentet për çështjet, të cilat kërkonin një sqarim të mëtejshëm ose diktonin një paqartësi për interpretimin e dispozitave nga ana e Bankës së Shqipërisë, janë analizuar gjatë një dëgjese publike.

Në vijim të konsultimit publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ka publikuar paketën e plotë të projektligjit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE